



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 429 Prot

Tiranë, më 02/3/2021

VENDIM

Nr. 13, datë 02.3.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6 dhe 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës c), d) dhe e), të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me shkronjën e) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, sipas së cilës *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kompetencë monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit”,* ka kryer monitorimin on-line të transparencës proaktive të Autoritetit Publik “Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”) parashikohet se: *“Autoriteti Publik vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”.*

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.*

Nga monitorimi i kryer në faqen zyrtare <http://www.ikmt.gov.al/>, rezultoi se Autoriteti Publik, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 1, të nenit 4 dhe nenit 6 të LDI, për të vendosur në zbatim programin institucional të transparencës sipas Urdhrit nr. 14, datë 22.01.2015, “Për miratimin e Programit Model të Transparencës”¹, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Konkretisht, nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik nuk ka vendosur në zbatim Programin Model të Transparencës, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri.

Në përfundim të procesit të monitorimit, Zyra e Komisionerit hartoi raportin përkatës. Me qëllim prezantimin e Raportit të Monitorimit të Programit të Transparencës dhe komunikimin e gjetjeve të tij për secilin autoritet publik, përfshirë dhe Autoritetin Publik/Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, si dhe me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 10 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, me shkresën nr. 21 Prot., datë 06.01.2021, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore, si hap paraprak, mbajtur me datë 14.01.2021, në të cilën u prezantua raporti i monitorimit të Programit të Transparencës edhe për Autoritetin Publik/Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Në përfundim të seancës, Autoritetit Publik i u la afat për dërgimin e qëndrimit në lidhje me rezultatet e monitorimit deri me datë 18.01.2021. Në tejkalim të afatit të përcaktuar, nuk rezultoi që Autoriteti Publik të ketë informuar Zyrën e Komisionerit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore të sipërcituara.

Në ndjekje të procedurës së hetimit administrativ, në përputhje me nenin 31/1, shkronja “c” e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe nenit 87 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nëpërmjet shkresës nr. 217 Prot., datë 27.01.2021, Komisioneri kërkoi nga titullari i institucionit, në cilësinë e subjektit përgjegjës sipas nenit 19 të LDI, të paraqesë qëndrimin dhe provat përkatëse, brenda datës 02.02.2021.

Në lidhje me mospërmbushjen e detyrimit të përcaktuar për vënien në zbatim të Programit Model të Transparencës së Autoritetit Publik me shkresën nr. 590/1 Prot., të datës 02.02.2021, ka kthyer përgjigje ku sqaron se për shkak të ristrukturimit institucional, faqja është në ndërtim dhe po punohet për plotësimin e programit me informacionin, si dhe kërkojnë trajnim nga Zyra e Komisionerit për implementimin e programit.

Nga verifikimi në faqen zyrtare rezultoi se nuk ka publikuar asnjë nga rubrikat e informacionin që duhet të jetë publik në programin e transparencës. Tabela e Programit të Transparencës nuk është e publikuar.

¹ Ndryshuar me Urdhrin nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës, të rishikuar”

Në pikën 3, të nenit 88 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Organi publik merr vendimin përfundimtar vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e së drejtës për t’u dëgjuar nga pala. Mos ushtrimi i kësaj së drejte nga ana e palës në afatin e përcaktuar, nuk shkakton shtyrjen e marrjes së vendimit përfundimtar”*.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë.

LDI promovon qasjen për dhënien e informacionit pa kërkesë përmes hartimit dhe miratimit të programit institucional të transparencës. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili duhet publikohet në faqen zyrtare, autoritetet publike vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Bazuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin Model të Transparencës, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha këto autoritete publike.

Programi Model i Transparencës, është hartuar në përputhje me nenin 7 të LDI dhe i përshtatur në kontekstin e veprimtarisë administrative të Autoriteteve Publike në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës dhe LDI.

Programi Model i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës së autoriteteve publike, që çdo autoritet është i detyruar ligjërisht ta zbatojë atë.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet, kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Nga monitorimi i kryer nga ana e Zyrës së Komisionerit dhe hetimi i thelluar më pas, në përputhje me nenin 41, 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, rezultoi se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ligjor për publikimin e Programit të Transparencës. Ristrukturimi i institucionit rezultoi se është bërë nëpërmjet VKM nr. 513, datë 01.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 893, datë 04.11.2015 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”.

Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik ka patur në dispozicion gjithë kohën e nevojshme për të përmbushur detyrimin e tij ligjor, të lidhur drejtpërdrejtë me ushtrimin nga ana e qytetarëve të së drejtës së tyre kushtetuese për informim.

Pika 1 e nenit 18 të LDI, parashikon se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*.

Në pikën 2 të nenit 18 të LDI, parashikohet se: *“Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë: b) mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë.*

Në pikën 1 të nenit 19 të LDI, parashikohet se: *“Titullari i institucionit mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje të parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji”.*

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për vënien në zbatim të Programit Model të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 14, datë 22.01.2015, “Për miratimin e Programit Model të Transparencës”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mosveprim i cili konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me shkronjën “b”, pika 2 e nenit 18 të LDI.

Në vendosjen e sanksionit, nga ana e Komisionerit është mbajtur në konsideratë fakti se asnjë kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 të LDI, nuk gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 19, shkronjën “b”, të pikës 2 të nenit 18, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën d) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Autoriteti Publik “Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit”, në zbatim të gërmave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 6 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të vendosë në zbatim Programin Model të Transparencës në përputhje me urdhrin nr.14, datë 22.01.2015 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndryshuar me Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës”, të rishikuar, brenda datës 31.3.2021.

2. Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik znj. Dallëndyshe Bici, Kryeinspektor i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë

mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 1 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1, pala ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë sipas Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

6. Ky vendim u dha sot në datë 02.3.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

